



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kuvendi Komunës së Prizrenit

Nr. 001/011 - 68303

Më: 29 maj 2025

Në bazë të nenit 12 paragrafit 2 shkronja d) dhe nenit 40 paragrafit 2 shkronja l) të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, nenit 7 paragrafit 3 të Ligjit Ligji Nr. 06/L-092, për Dhënie e Pronës Komunale në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 16 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 27 paragrafit 1, dhe nenit 50 shkronja a) dhe l) të Statutit të Komunës së Prizrenit, Nr. 01/011-5643, të datës 15 tetor 2008, pas shqyrtimit të propozimit të Kryetarit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur më 29 maj 2025, miratoi këtë:

VENDIM PARAPRAK
MBI DHËNIEN E PRONËS KOMUNALE NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR
ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE

Neni 1

Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës së Prizrenit që të merret Vendimi Paraparak për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër ngastrën kadastrale nr.11048-17 ZK Prizren, Organizatës Shoqërore Civile e cila vepron në territorin e Komunës së Prizrenit, me qëllim të përmbushjes së Interesit të Përgjithshëm Publik në kuadër të kompetencave të komunës, Ndërtimin e objektit “Qendra e Autizmit”, i cili do të zhvillojë aktivitete të veçanta dhe do të ju ofrojë shërbime psiko-sociale dhe aktivitete rekreative për personave me autizëm dhe personave tjerë me nevojë.

Neni 2

Ngastra kadastrale që do të epet në shfrytëzim, pranë zyrës së kadastrit, është evidentuar si pronë komunale KK Prizren me nr.11048-17, në sipërfaqe prej 1415 m² ZK Prizren.

Neni 3

Dhënia e pronës komunale në shfrytëzim organizatës shoqërore civile, konform këtij Vendimi është arsyeshmëria e Interesit të Përgjithshëm Publik në kuadër të kompetencave të komunës, Ndërtimin e objektit “Qendra e Autizmit”, i cili do të zhvillojë aktivitete të veçanta dhe do të ju ofrojë shërbime psiko-sociale dhe aktivitete rekreative për personave me autizëm dhe personave tjerë me nevojë.

Neni 4

Periudha kohore për dhënie e pronës komunale që epet në shfrytëzim është afatshkurtër dhe atë në periudhën prej 15 viteve.

Prona komunale që do të jepet në shfrytëzim afatshkurtër është në pajtueshmëri me dokumentacionin e planifikimit hapësinor.

Neni 5

Prona Komunale që epet në shfrytëzim afatshkurtër, nuk mund ta ndërron titullarin juridik, pronarin e ngastrës kadastrale mbetet në pronësi të Komunës së Prizrenit dhe si e tillë nuk mund të epet në shfrytëzim personit të tretë nga ana e shfrytëzuesit të zgjedhur si fitues në ankand-nuk mund të tjetërsohet, prona nuk mund të jetë barrë tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë komunale.

Neni 6

Komuna e Prizrenit e ruan të drejtën kurdo herë sipas nevojës me qëllim të realizimit të interesave shoqërore apo publike të bëjë ndryshimin e kontratës me përfituesin e pronës së dhënë në shfrytëzim.

Neni 7

Procedura e dhënies së Pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes ankandit publik.

Neni 8

Obligohet Zyra e Prokurimit në bashkëpunimin me organet tjera komunale si dhe në bashkëpunim me Komisionin Vlerësues të Ofertave për Dhënie të Pronës Komunale në Shfrytëzim, të zhvillojnë procedurat e ankandit publik në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit nr. 06/L-092 dhe Rregullores nr.09/2020.

Neni 9

Kryetari Komunës së Prizrenit pas përfundimit të procedurave të tenderimit nga Komisioni Vlerësues, obligohet që të nënshkruajë kontratën mbi shfrytëzimin e pronës komunale në mes të Komunës dhe fituesit të ankandit, ku do të përcaktohen të drejtat, obligimet dhe përgjegjësit e të dyja palëve.

Neni 10

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Prizrenit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024” dhe pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen zyrtare të komunës.



Kryesuesja e Kuvendit
Antigona Bytyqi

Bytyqi